



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:194868
Datë: 13.06.2024
Numri i dokumentit: 05837273

Ac.nr.6893/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F. Sh., adresa: U. K. Klinë, të cilin me autorizim e përfaqëson F.G., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës K. e S. ‘E.’ me seli në Prishtinë, objekti i kontestit kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Klinë, C.nr.142/18, datë 21.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e paditësit F. Sh. nga Klina, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Klinë, C.nr.142/18, datë 21.07.2021 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.142/18, datë 21.07.2021, gjykata e shkallës së parë ka vendosur: I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit F. Sh. nga fshati U. K.Klinë, me të cilën ka kërkuar që të “Obligohet e paditura K. e S. ‘E.’ me seli në Prishtinë që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material-qirasë për shkak të qëndrimit të automjetit në parking-pllacë deri në riparimin e saj, si dhe në emër të qiras për shfrytëzimin e veturës të marrur me rent paditësit F. Sh., të ja paguaj shumën prej 910.00 € dhe këtë me kamatë prej 8%, nga momenti i dorëzimit të padisë deri në përmbushjen e detyrimit, si dhe të paguajë shpenzimet procedurale, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm” SI E PA BAZUAR. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur paditësi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ka propozuar që të aprovohet ankesa dhe të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, apo të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ashtu që lënda të kthehet në rigjykim.

E paditura nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

- Ankesa e paditësit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi F. Sh. përmes përfaqësuesit të tij me datë 17.04.2018 ka parashtruar padi ndaj të paditurës, duke kërkuar kompensimin e dëmit material. Ai ka paraqitur se me datë 27.10.2017 ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në të cilin paditësi kishte pësuar dëme në automjet. Paditësi për këtë dëm kishte paraqitur kërkesë për kompensim të dëmit material, mirëpo e paditura i është përgjigjur pas rreth 3 muajve, duke i ofruar një ofertë për rregullim veture, apo 540€ si kundërvlerë. Sipas tij, e paditura ka dështuar që brenda afateve ligjore të trajtoj kërkesën e paditësit për rregullimin e veturës. Për këtë paditësi ka qenë i detyruar të marr një veturë me qira, po ashtu është bartur nga një kompani për bartjen e veturave.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.142/18, datë 21.07.2021, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se pala paditëse në emër të dëmit material është kompensuar dhe ju ka rregulluar automjeti për demet që ka pësuar në aksidentin e ndodhur me dt.27.10.2017, dhe atë ne shumën prej 2.224 euro, që i ka kushtuar rregullimi i automjetit të paditësit dhe atë ne autoservisin “B.”. Më tej ka arsyetuar se dëmi i cili ju ka shkaktuar ne aksident ne tërësi është realizuar prandaj ne bazë te sigurimit te autopergjegjsis nuk është e paraparë taksativisht qe të bëhen zhdëmtime te tjera palës se dëmtuar përveç dëmit kryesor qe shkaktohet ne aksident, gjatë zhvillimit të procedurës në këtë çështje juridiko-civile dhe sipas shkresave të lëndës shihet se automjeti është rregulluar te servisi B. ku edhe sipas deklaratës së paditësit vetura e tij është riparuar dhe nuk ka ndonjë vërejtje për riparim-rikthim në gjendjen e mëparshme, andaj për vonesat e plotësimit të dokumentacionit nga pala paditëse nuk mund të kërkohet nga e paditura dëmshpërblim sipas faturave pasi që prolongimin e procedurës e ka bërë vetë pala paditëse.

Gjykata e Apelit nuk e përkrah vlerësimin dhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe ligjshëm pasi që vlerëson se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 par.1, në atë mënyrë që faktet vendimtare nuk janë vërtetuar dhe arsyetuar në masën e duhur dhe të mjaftueshme, për çka edhe është bërë vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike, si rezultat i së cilës nuk është bërë zbatimi i duhur i të drejtës materiale për të cilën shkelje gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Në analizë të pretendimeve ankimore, kolegji i kësaj gjykate gjeti se vendimi i ankimuar ka të meta nga neni 160 par. 5, i cili përcakton se *Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve*. Aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban fare asnjë dispozitë nga e drejta materiale, gjë të cilën ka qenë dashur të bëjë me rastin e hartimit të arsyetimit, në këtë mënyrë nuk është sqaruar në masë të duhur se si i ka vlerësuar faktet nga perspektiva e të drejtës materiale.

Përveç shkeljeve procedurale të cekura më lartë të cilat përbëjnë bazë të mjaftueshme procedurale për ta prishur aktgjykimin e atakuar, Gjykatës së Apelit i rezultoi se marrja e një aktgjykimi të tillë nga gjykata e shkallës së parë është bërë duke mos e vërtetuar plotësisht gjendjen faktike, gjegjësisht duke mos dhënë vlerësimet e duhura e që si rrjedhojë ka pasur edhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, për të cilën gjykata e shkallës së dytë kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Fillimisht gjykata e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa u thelluar në masë të duhur ka bërë përshkrim të procedurës që ka ndjekur paditësi tek e paditura që ka të bëjë me kërkesën për kompensim gjegjësisht rregullim të automjetit. Nga analizimi i provave që ka administruar gjykata e shkallës së parë mund të vërehet se e paditura i ka kthyer përgjigje paditësit, por nuk është vlerësuar drejtë nga nëse përgjigja ishte brenda periudhës kohore që përcakton Ligji nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Për sa i përket faturës së datës 03.01.2018 dhe kuponit fiskal sipas asaj fature, gjykate nuk e ka vlerësuar në masë të duhur, ngase në padi po ashtu edhe në seanca gjyqësore, paditësi ka cekur se fatura i referohet bartjes si dhe parkingut të veturës. Gjykata do të duhej të arsyetonte nëse ajo faturë përmban ditët se sa ka qëndruar në parking vetura, apo se e njëjta kërkohet vetëm për sa i përket auto bartjes nga vendi i aksidentit. Për sa i përket faturës së dytë datë 28.10.2017, gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye për besueshmërinë apo jo të saj, si dhe nevojës për të marr paditësi një automjet në përdorim, gjegjësisht lidhjes kauzale ndërmjet dëmit që i është shkaktuar, si dhe ditëve që ka shfrytëzuar automjetin.

Si rrjedhojë, për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, e që i referohen vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, por është dashur që të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda të rikthehet në rigjykim dhe vendosje.

Bazuar në arsyet e paraqitura, aprovohen si të bazuara pretendimet ankimore lidhur me këto shkelje dhe me rastin e marrjes së lëndës në rishqyrtim dhe rivendosje, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të ndër marrë veprime të caktuara për eliminimin e shkeljeve të përmendura si më lartë, në pajtim me dispozitat ligjore. Pas vërtetimit të gjitha fakteve dhe kryerjes së të gjitha veprimeve që i ka për obligim si gjykatë, e njëjta udhëzohet t'i kushtoj kujdes vërtetimit të gjendjes faktike për sa i përket procedurës që ka ndjekur paditësi për kompensimin e dëmit, në shkresa të lëndës gjendet kërkesa si dhe përgjigja e të paditurës. Më pas udhëzohet gjykata e shkallës së parë që të vërtetoj nëse fatura e datës 03.01.2018 i referohet bartjes apo vend parkimit, ngase paditësi ka bërë një miksim të pretendimeve, të cilat udhëzohet gjykata t'i vërtetoj drejtë. Përveç kësaj, lidhur me faturën e datës 28.10.2017, gjykata të vërtetoj saktë ditët e nevojshme për marrjen e veturës në përdorim, deri në kohën ku kompania të jetë zotuar për rregullimin e veturës, brenda afateve ligjore. Për të dy faturat, gjykata duhet të vërtetoj drejtë faktet për sa i përket lidhjes kauzale, ndërmjet dëmit që i është shkaktuar në veturë dhe realisht nevojës për secilin nga shpenzimet që pretendon që i ka bërë paditësi, ngase në shkresa të lëndës nuk dëshmi se deri në çfarë mase është dëmtuar automjeti dhe nëse ka qenë jashtë qarkullimit të rregull. Në fund, udhëzohet gjykata e shkallës së parë, që me rastin e përpilimit të aktgjykimit, t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozita e neni 160 të LPK-së (të hartoj dispozitivin e aktgjykimit në përputhje me par. 3 të nenit 160 të LPK-së, si dhe të paraqes arsyetimin në pajtim me parag.4 të këtij neni), ashtu që pas administrimit të provave të propozuara nga të dyja palët ndërgjyqëse dhe vlerësimit të arsyetuar detajisht të provave që i shqyrton dhe i administron, të vendosë për kërkesëpadinë e palës paditëse, me referencë të qartë në dispozita të së drejtës materiale.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të nenit 194 dhe 195, paragraf 1, pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
AC.nr.6893/2021, datë 13.06.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli